



**KËSHILLI I BASHKIMIT  
EVROPIAN**

**Bruksel, 16 shkurt 2008  
S060/08**

**Javier SOLANA,  
Përfaqësues i Lartë i BE-së për Politikë të Përbashkët të  
Jashtme dhe Siguri,  
përshëndet emërimet e Pieter FEITH  
si Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë dhe  
Yves de KERMABON si Shef i Misionit EULEX KOSOVË**

Javier SOLANA, Përfaqësues i Lartë i BE-së për Politikë të Përbashkët të Jashtme dhe Siguri bëri sot deklaratat e mëposhtme lidhur me vendimin e Këshillit për emërimin e Pieter FEITH si Përfaqësues Special i BE-së në Kosovë dhe Yves de KERMABON si Shef i misionit EULEX KOSOVË.

*“Jam shumë i kënaqur që në bazë të rekomandimeve të mia, Këshilli ka vendosur për të emëruar Pieter Feith si Përfaqësues Special të BE-së në Kosovë dhe Yves de Kermabon si Shef për sundimin e ligjit në Kosovë, EULEX KOSOVË. Këto emërite ilustrjnë edhe më tej angazhimin e shtuar të BE-së në Ballkanin Perëndimor.*

*Pieter Feith, në veçanti do të ofrojë këshilla dhe mbështetje nga ana e BE-së në procesin politik dhe do të promovojë koordinim të përgjithshëm të BE-së në Kosovë. E kam njohur atë për një kohë të gjatë dhe gjithmonë kemi punuar mirë së bashku. I dëshiroj fat në postin e tij.*

*Si Shef i Misionit më të madh civil të BE-së deri më tani, Yves de Kermabon, do të ketë rol vendimtar për t'i ndihmuar policisë, drejtësisë dhe agjencive për zbatimin e drejtësisë në Kosovë në përparimin e tyre drejtë standardeve evropiane. Ai ka besimin dhe mbështetjen time të plotë dhe mezi pres të punoj me te.*

*‘Të dytë kanë njohuri të thella për rajonin dhe për politikën e BE-së atje’.*

Këshilli i Evropës, më 14 dhjetor 2007, ka theksuar gatishmërinë e BE-së për ta ndihmuar Kosovën në rrugën e saj drejt stabilitetit të qëndrueshëm, po ashtu edhe përmes misionit të Politikës Evropiane për Siguri dhe Mbrojtje si dhe kontributit të zyrës civile ndërkombëtare si pjesë të pranisë ndërkombëtare në Kosovë.

Sot, Këshilli po ashtu ka vendosur për fillimin e misionit EULEX KOSOVË në një fushë më të gjerë të Sundimit të Ligjit.

**PER DETAJE TJERA:**

Spokesperson of the Secretary General, High Representative for CFSP

☎ +32 (0)2 281 6467 / 8239 / 5150 / 5151 ☎ +32 (0)2 281 5694

internet: <http://www.consilium.europa.eu/solana>

e-mail: [presse.cabinet@consilium.europa.eu](mailto:presse.cabinet@consilium.europa.eu)

---